



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

Tiranë më,

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Shoqëria **“MEDI - TEL” Shpk**

*Adresa: Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Rruga Vidhegiate, Ndertesa Nr.18, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.pronesia 41/1/16/2*

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-94850-11-20-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për QSUT për vitin 2019”**, me fond limit: **4 360 600** (katër milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH** dhe **5 232 720** (pesë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet) **lekë me TVSH**. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: Nga nenshkrimi i kontratës deri në 31.12.2019.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [26.11.2018] [Nr: 47]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ✓ oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “W-Center” Shpk**

K63029402A

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera: **4 154 000** (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) **lekë pa TVSH** dhe **4 984 800** (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë katër mijë e tetëqind) **leke me TVSH**

**2. “MEDI - TEL” shpk**

J71519004W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera: **4 358 100** (kater milion e treqind e pesëdhjetë e tete mije e njëqind) **lekë pa TVSH** dhe **5 229 720** (pese milion e dyqind e njëzet e nënte mije e shtatëqind e njezet) **lekë me TVSH**

**3. “PREND STOJANI”**

K37506519U

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera: **4 360 600** (katër milion e treqind e gjashtëdhjetë mije e gjashtëqind) **leke pa TVSH** (ne formularin e ofertës, është vendosur vetëm vlera pa TVSH)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

## 1. “W-Center” Shpk

K63029402A

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Ne baze të shtojcës 8, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, **pika 1.a)**, në Dokumentet Standarte të Tenderit, Operatori ekonomik është i regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit, por nuk ka fushë të veprimtarisë objektin e prokurimit, konkretisht **“Materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”**
- b) **Sa i përket kriterëve të vecanta, Shtojca 8, pika 2.3/a)**, në Dokumentet Standarte të Tenderit, Operatori nuk ka paraqitur dëshmi të furnizimeve të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit. Konkretisht kontrata e ngjashme që ka paraqitur është me objekt **“Furnizim me materiale pastrimi”** objekt i cili nuk mund të quhet i ngjashëm me objektin konkret të prokurimit në baze të Ligjit Nr.9537 datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”, Ligjit Nr.9010 datë 13.02.2003 “Administrimit Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”, Ligjit Nr.9537 datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”, në “Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore” të miratuar me Nr.Prot.1622/1 datë 20.03.2016.
- c) Operatori nuk ka zbatuar piken 2.3/d) të shtojcës Nr.8, sa i përket paraqitjes së certifikatës ISO 9001:2015 mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësive”** në përputhje me objektin e prokurimit. Konkretisht certifikata e paraqitur nga ofertuesi, nuk është në përputhje me objektin e prokurimit.
- d) Operatori nuk ka zbatuar piken 2.3/dh) të shtojcës Nr.8, sa i përket paraqitjes së certifikatës ISO 14001:2015 mbi **“Sistemet e menaxhimit të ambjentit”** në përputhje me objektin e prokurimit. Konkretisht certifikata e paraqitur nga ofertuesi, nuk është në përputhje me objektin e prokurimit.
- e) Operatori nuk ka zbatuar piken 2.3/b) sa i përket paraqitjes së mostrave në ditën e hapjes së ofertave. Konkretisht operatori ka paraqitur mostrat të shoqëruara me një deklaratë në të cilën përshkruhen mostrat e dorëzuara, por përshkrimi në deklaratë nuk është në përputhje me karakteristikat e mallit të dorëzuar në datën dhe orën e hapjes së tenderit.

Në deklaratë thuhet që në listen e kampioneve /mostrave janë:

- Qese ngjyre e zeze profesionale për përdorim spitalor, nderkohe që mostra e dorëzuar (qesja) është **ngjyre blu dhe jo sipas materialit të kerkuar në Specifikimet Teknike në DST**, nuk ka etikete me permasat 75 mm X 75 mm dhe simbolin e biohazard (në Rregulloren e brendshme mbi Administrimin e mbetjeve spitalore në QSUT, Ligjit Nr.9537 datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”. **Duke patur parasysh argumentet e parashtruara më lart, artikulli nuk mund të merret në konsideratë si mostër nga KVO.**
- Cante (qese) ngjyre e verdhe për mbetjet e rrezikshme spitalore, **nuk ka të evidentuar në paketim origjinalin e mallit**, që është kerkuar në DST për të gjithë artikujt të paraqitur si mostra. **Duke patur parasysh argumentet e parashtruara më lart, artikulli nuk mund të merret në konsideratë si mostër nga KVO.**
- Kosh, nga 20-50l për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyre të verdhe . Konkretisht operatori ka paraqitur në mostër **kosh me ngjyre të verdhe me kapak të kuq, jo sipas kërkesave në DST dhe specifikime teknike**. Në piken 4.2.4 të Rregullores së brendshme mbi Administrimin e mbetjeve spitalore në QSUT, argumentohet Kodimi me ngjyra i ambalazhimit, i cili bëhet për të mundësuar identifikimin e lehtë të mbetjeve

spitalore esenciale per trajtimin e mevonshem. Ne kete menyre duhet qe ambalazhimi i mbetjeve spitalore te ndjeke kodimin me ngjyra te specifikuara. **Duke patur parasysh argumentet e parashtruara me lart, artikulli nuk mund te merret ne konsiderate si moster nga KVO.**

- Kosh me dy rrota ne pjesen e pasme, ngjyre te verdhe, deri ne 150 litra.

Konkretisht **Operatori ekonomik ka sjelle si moster Kosh, kontenier me ngjyre te gjelber**, 110 litra, nuk ka doreze anesore nga krahu i rrotave, nuk eshte ne materialin e kerkuar sipas specifikimeve teknike sipas Rregullores se brendshme mbi Administrimin e Mbetjeve Spitalore, VKM-se 798, date 29.09.2010 “Mbi Administrimin e Mbetjeve Spitalore”. Ne piken 2.3b) te shtojces Nr.8 ne DST thuhet :*Nese mostrat e dorezuara nuk jane te shoqeruara me listen e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor te formularit te cmimit, nese ka mungesa mostrash per artikuj te vecante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi, atehere oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.* Duke patur parasysh argumentet e parashtruara me lart, artikulli nuk mund te merret ne konsiderate si moster nga KVO.

## 2. “PREND STOJANI”

**K37506519U**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion te vlefshem referuar Dokumentave Standarte te Tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga **Shoqëria “MEDI - TEL” shpk**, me adrese: *Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Rruga Vidhegiate, Ndertesa Nr.18, Zona Kadastrale Nr: 2679, Nr: pronesia 41/1/16/2*, përfaqësuar nga Administratori Z. Anastas Pecini me një vlerë të përgjithshme prej: **4 358 100** (kater milion e treqind e pesëdhjete e tete mije e njëqind) **lekë pa TVSH** dhe **5 229 720** (pese milion e dyqind e njëzet e nënte mije e shtatëqind e njezet) **lekë me TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

**Public Health Sector**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë** me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tirane sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.12.2018**

Ankesa: Nuk ka patur

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Enkelejdi JOTI**